



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

R. nr. 94/2024

lidhur me

*mohimin e të drejtës në reduktimin e tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjik,
tetraplegjik dhe për personat e verbër*

Për:

Z. Hekuran Murati, Ministër
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Kopje:

Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 11 prill 2025

QËLLIMI I RAPORTIT

1. Ky Raport ka për qëllim që për nga perspektiva e të drejtave të njeriut t'i analizojë dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Ligjit Nr.04/L-092 për Personat e Verbër, në raport me programit për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike të miratuar nga Qeveria në shtator të vitit 2023.

Me programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike subvencionohen faturat e energjisë elektrike për konsumatorët e cenueshëm, të ardhurat mesatare mujore të të cilëve janë nën 150 euro për anëtar të familjes. Përderisa, të dy këto ligje parashohin që këto dy kategori të shoqërisë (personat me statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik dhe personat e verbër) të përfitojnë nga reduktim, respektivisht lehtësira të tarifave të energjisë. Me miratimin e këtij programi është anashkaluar zbatimi i këtyre dispozitave ligjore, për faktin se këta persona me këtë status nuk janë duke përfituar pavarësisht garancive ligjore. Ky raport synon të adresoj këtë çështje.

KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

2. Avokati i Popullit, sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, par. 1);*
 - *të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave (neni 18, par. 1, nënpar. 4);*
 - *të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit. (neni 18, par. 1, nënpar. 5);*
 - *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta. (neni 18, par. 1, nënpar. 6);*
 - *të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës. (neni 18, par. 1, nënpar. 7);*
 - *t'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv. (neni 18, par. 1, nënpar. 9).*
3. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t'i kryejë këto përgjegjësi ligjore.

RRETHANAT E RASTIT

4. Avokati i Popullit më 1 shkurt 2024 pranoi ankesën e z. Afrim Maliqit, drejtor i shoqatës HANDIKOS, parashtruar kundër Qeverisë së Kosovës, lidhur me lansimin e Programit për mbështetjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike, nga i cili program, sipas tij, u përjashtuan personat me aftësi të kufizuara.
5. Ankuesi i referohet Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 14, i cili përcakton se përfituesit e këtij ligji gëzojnë reduktim në tarifa të konsumimit të energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara nga organet kompetente, si dhe Ligjit Nr.04/L-092 për Personat e Verbër, neni 14, paragrafi 1, sipas të cilit, të gjithë personat e verbër gëzojnë lehtësira në konsumin e energjisë elektrike.
6. Sipas ankuesit, deri në fund të vitit 2022 personat paraplegjik, tetraplegjik dhe personat e verbër përfitonin nga reduktimi i tarifave të konsumimit të energjisë elektrike. Mirëpo, sipas ankuesit, në shtator të vitit 2023, Qeveria miratoi dhe lansoi Programin për mbështetjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike, nga i cili, sipas ankuesit, asnjë person i cili ka status të personit të verbër apo të personit paraplegjik dhe tetraplegjik, për vitin 2023, nuk përfitoi nga reduktimi i tarifave të konsumimit të energjisë elektrike, ashtu siç edhe parashihet me ligjet përkatëse.
7. Më 18 mars 2024, Avokati i Popullit iu drejtua Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me ç'rast kërkoi informata lidhur me pretendimet e ankuesit dhe informata lidhur Programin për mbështetjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike.
8. Duke marrë parasysh se MFPT nuk ktheu përgjigje brenda afatit të përcaktuar, Avokati i Popullit, më 10 qershor 2024, iu drejtua MFPT-së duke e ripërsëritur kërkesën për informacione, datë 18 mars 2024.
9. Më 27 qershor 2024, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga MFPT-ja, me të cilën njoftoi se më 5 shtator 2023, Qeveria miratoi Programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike. Sipas MFPT-së, ky program parasheh t'i mbështesë kategoritë më të cenueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, prindërit vetushqyes dhe pensionistët. Sipas MFPT-së, Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike është i fokusuar në subvencionimin e faturave të energjisë elektrike për konsumatorët e cenueshëm, të ardhurat mesatare mujore të të cilëve janë nën 150 euro për anëtar të familjes.
10. Më 16 shtator 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mbajti takim me ankuesin, me ç'rast i kërkoi informata lidhur me numrin e personave që përfituan nga reduktimi i tarifave të energjisë elektrike në tri vitet e fundit.
11. Më 4 tetor 2024, ankuesi përcolli informatat të cilat ishin siguruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe tani nga MFPT-ja, sipas të cilave, në vitin 2017 përfitues të reduktimit të faturave të energjisë elektrike kanë qenë 727 persona. Më tej në përgjigje thuhet se në vitin 2022 kanë qenë 2354 persona paraplegjik/tetraplegjik dhe 1260 persona të verbër përfitues të subvencionimit të energjisë.

ANALIZA LIGJORE DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

12. Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, në nenin 14 përcakton:

“Përfituesit e këtij ligji gëzojnë reduktim në tarifa të konsumimit të energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara nga organet kompetente.”

13. Ligjit Nr.04/L-092 për Personat e Verbër, neni 14, paragrafi 1, përcakton:

“Të gjithë personat e verbër, gëzojnë lehtësira në konsumin e energjisë elektrike sipas Ligjit të Skemës Sociale.”

14. Avokati i Popullit vëren se deri në fund të vitit 2022 këto grupe të personave përfituan nga reduktimi i tarifave të konsumimit të energjisë elektrike, bazuar në ligjet përkatëse, kurse me Programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike, i miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 5 shtator 2023, përfitimi nga reduktimi i tarifave të konsumimit të energjisë elektrike ndërlihet me ardhurat mesatare mujore për anëtar të familjes.

15. Avokati i Popullit vëren se personat paraplegjik/tetraplegjik dhe personat e verbër, nga viti 2017 deri në vitin 2022, me bazën e njëjtë ligjore, gjegjësisht bazuar në Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe në Ligjin Nr.04/L-092 për Personat e Verbër, kanë përfituar nga reduktimi në tarifa të konsumimit të energjisë elektrike. Ndërsa me lansimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike, personat paraplegjik/tetraplegjik dhe personat e verbër mund të jenë përfitues në rast se të ardhurat mesatare mujore janë nën 150 euro për anëtar të familjes.

16. Avokati i Popullit konstaton se të drejtat që rrjedhin nga Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik si dhe nga Ligji për Personat e Verbër nuk duhet të ndërlihen me të ardhurat mesatare mujore të anëtareve të tjerë të familjes, por bazuar në statusin e tyre të përcaktuar me ligjet e veçanta, e që njëherësh kanë përparësi në zbatim sipas parimit *lex specialis derogat legi generali*. Sipas këtij parimi, duke marrë parasysh faktin se reduktimi i tarifave të konsumit të energjisë elektrike për personat paraplegjik/tetraplegjik dhe personat e verbër është specifikisht i rregulluar me ligje të veçanta, atëherë për këta persona duhet të zbatohen këto dispozita, pa marrë parasysh ligjet apo rregullat e tjera të përgjithshme.

17. Avokati i Popullit vë në pah krijimin e pritjeve legjitime për personat paraplegjik/tetraplegjik dhe personat e verbër. Pritja legjitime lidhet me pritshmërinë e arsyeshme të individëve për trajtim të drejtë dhe të ligjshëm nga autoritetet publike. Ky parim nënkupton që qytetarët kanë të drejtë të presin që institucionet shtetërore të veprojnë në përputhje me ligjin dhe praktikën e vendosur. Përderisa reduktimi i tarifave për personat paraplegjik/tetraplegjik dhe për personat e verbër është i përcaktuar me ligjet përkatëse dhe përderisa reduktimi i tarifave është zbatuar në praktikë, duke pasur edhe rritjen e numrit të përfituesve nga viti në vit, ndryshimi i kësaj situate në mënyrë të papritur nëpërmjet Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike, i miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 5 shtator 2023, përbën cenim të pritjeve legjitime që burojnë nga ligji dhe praktika.

18. Avokati i Popullit vëren se Republika e Shqipërisë, çështjen e reduktimit të tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjik/tetraplegjik dhe për personat e verbër e përcakton me ligjet e veçanta për këto grupe. Këto ligje e autorizojnë ministrinë përkatëse që ta përcaktojë masën e kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën

e energjisë elektrike dhe për faturën e telefonisë fikse. Ndërsa në Republikën e Kosovës, përveç dispozitave përkatëse, të cilat thjesht përcaktojnë reduktime dhe lehtësira në tarifën e energjisë elektrike për personat paraplegjik/tetraplegjik dhe për persona të verbër, nuk ka ndonjë akt nënligjor, i cili rregullon zbatimin e këtyre dispozitave. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e vlerëson si të nevojshme nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin e mënyrës dhe masës së reduktimit të tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjik/tetraplegjik dhe për personat e verbër.

Së këndejmi, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve:

1. Nxjerrjen e një Udhëzimi Administrativ për kriteret për reduktim në tarifa të konsumit të energjisë elektrike për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, në funksion të zbatimit të Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
2. Nxjerrjen e një Udhëzimi Administrativ për kriteret për reduktim në tarifa të konsumit të energjisë elektrike për personat e verbër në funksion të zbatimit të Ligjit Nr.04/L-092 për Personat e Verbër.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit